

Vendim nr. 281, datë 07.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 07.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **BASHKIA E TIRANËS**, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-488, datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga materialet e dosjes ka rezultuar se me vendimin nr. 342, datë 08.10.1986 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë shtetasit Pranvera dhe Astrit Merlika janë njohur trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të shtetasit Faik Merlika, i cili ka vdekur në vitin 1986 dhe sipas pretendimeve të tyre ka pasur në pronësi të tij dy shtëpi banimi, një në Krujë dhe një në Tiranë, sipas vërtetimit hipotekar, datë 20.11.1991, të lëshuar nga Zyra e Hipotekës së Krujës dhe vërtetimit, datë 04.10.1992, të lëshuar nga Zyra e Hipotekës Tiranë.

2. Mbi bazën e këtyre vërtetimeve, Pranvera dhe Astrit Merlika/palë paditëse i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke paditur Komitetin Ekzekutiv Pluralist të qytetit të Krujës, ndërmarrjen komunale nr.3, për kërkimin e pasurisë së konfiskuar, në bazë të nenit 5, shkronja “d”, të ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 124, datë 02.04.1992, ka vendosur detyrimin e Këshillit Popullor Pluralist të qytetit të Krujës t’u kthejë trashëgimtarëve Faik Merlika ndërtesën dykatëshe të përbërë nga tetë dhoma të ndodhura në atë qytet dhe detyrimin e NRSH-së nr. 3 Tiranë dhe NKB-së nr. 3 Tiranë, t’u kthejnë trashëgimtarëve të radhës së parë të trashëgimlënësit Faik Merlika, ndërtesën katërkatëshe që ndodhet në lagjen “17 Nëntori”, rruga “Kongresi i Përmetit”, të përbërë nga 28 dhoma, 7 korridore, 6 banja e 5 dyqane, të regjistruara sipas hipotekës, datë 22 mars 1948, pranë Zyrës së Hipotekës Tiranë. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 18.04.1992, pasi nuk është ankimuar.

4. Pas kërkesës së palës paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 333, datë 06.11.1992, ka bërë interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 124, datë 02.04.1992 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, të paragrafit II, dhe me këtë përmbajtje: “Detyrimin e NRSH-së nr. 3, Tiranë dhe ndërmarrjes komunale nr. 3, Tiranë t’u kthejë dhe t’u lirojë trashëgimtarëve të radhës së parë të trashëgimlënësit Faik Merlika ndërtesën katërkatëshe që ndodhet në lagjen “17 nëntori”, rruga “Kongresi i Përmetit”, të përbërë nga 28 dhoma, 7 korridore, 6 banja e 5 dyqane, të regjistruara sipas regjistrimit hipotekar nr. 46, datë 22 mars 1948 pranë Zyrës së Hipotekës Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1, datë 05.01.1993, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë nr. 333, datë 06.11.1992, vetëm në pjesën që detyron NRSH-në nr. 3, Tiranë dhe ndryshimin e këtij vendimi në pjesën që detyron NKB-në nr. 3, Tiranë, t’u lirojë paditësve ndërtesën katërkatëshe në lagjen “17 Nëntori”, rruga “Kongresi i Përmetit”, duke rrëzuar kërkesën e

padisë. Ndërsa Gjykata e Kasacionit Tiranë, me vendimin e saj nr. 398, datë 14.04.1993, ka vendosur pushimin e gjykimit.

5. Në datën 18.07.2016 Bashkia e Tiranës ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për rishikimin e vendimeve nr. 124, datë 02.04.1992 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nr. 333, datë 06.11.1992 të po kësaj gjykate, i cili ka bërë plotësimin dhe interpretimin e vendimit nr. 124, datë 02.04.1992 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nr. 1, datë 05.01.1993 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ky i fundit i lënë në fuqi me vendimin nr. 398, datë 14.04.1993 të Gjykatës së Kasacionit Tiranë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-488, datë 12.02.2025, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimeve si të pabazuar në ligj.

6. Në datën 15.08.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkueses

7. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se gjatë procesit *gjyqësor* i është *cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

7.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, pasi arsytimi i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i pamjaftueshëm dhe është marrë në interpretim arbitrar të ligjit. Provat e paraqitura kanë qenë të reja e të pashqyrtuara më parë nga gjykatat dhe provonin se paditësi nuk ishte pronar i ndërtesës objekt gjykimi, por shteti shqiptar. Sipas provave të paraqitura, ka rezultuar qartësisht se palës paditëse i është kthyer një ndërtesë, e cila nuk i është sekuestruar për motive politike, por i është shtetëzuar, për shkak të detyrimeve që shtetasi Faik Merlika kishte ndaj shtetit shqiptar për shkak të tatimeve të jashtëzakonshme të luftës të parashikuara nga ligji i kohës. Avokatura e Shtetit ka sqaruar me hollësi përmbushjen e të gjitha kushteve të parashikuara në nenin 494/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Provat e paraqitura nuk janë debatuar nga palët dhe nuk i janë nënshtruar hetimit gjyqësor për arsye se nuk ishin paraqitur më parë, pasi dhe pala e paditur nuk i dispononte informacionet e duhura për t’ia parashtruar gjykatës. Për këto prova nuk ka pasur dijeni gjatë shqyrtimit të çështjes nga gjykata e faktit, pasi informacioni i plotë është

disponuar nga Avokatura e Shtetit vetëm në momentin kur Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, me shkresën nr. 5627/1, datë 16.12.2014, ka bërë kërkesë për bashkëpunim, pasi sipas disa dokumenteve trualli dhe objekti rezultonin në pronësi të shtetit. Po në kërkesën për rishikim, kërkuësja ka sqaruar se provat e paraqitura kanë rëndësi thelbësore për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes në përputhje me ligjin, pasi paditësit e kanë fituar pronësinë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, si dhe me nenin 162 të Kodit Civil. Nëse Gjykata e Lartë do të kishte vendosur kthimin e çështjes për rigjykim, mbi bazën e provave të reja, vendimmarrja e gjykata të juridiksionit të zakonshëm do të kishte qenë e ndryshme. Vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në interpretim arbitrar të ligjit duke cenuar standardin e arsytimit të vendimit të lidhur edhe me të drejtën për akses, pasi çështja nuk ka marrë zgjidhje përfundimtare.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në vijim, në zbatim të standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetues, Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë.

10. Duke mbajtur në konsideratë që kërkuësja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që nuk ka pranuar kërkesën për rishikimin e vendimit gjyqësor, për të cilin nuk ka mjete të tjera ankimi, ajo e ka përmbushur kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në

dispozicion. Po kështu, kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 12.02.2025, por është bërë i disponueshëm në datën 24.04.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 15.08.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit organik të Gjykatës.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, duke argumentuar se Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën për rishikim në kundërshtim me ligjin. Sipas saj, kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është bazuar në shkronjën “a” të nenit 494 të KPC-së, duke pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë kryer hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

12. Duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuëses, Kolegji do të analizojë nëse Gjykata e Lartë ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

13. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në veçanti e Gjykatës së Lartë, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë nëse gjatë procesit

gjqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor ka nisur pas kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të paraqitur nga kërkuësja në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka evidentuar se kërkesa për rishikim është depozituar në atë gjykatë në datën 18.07.2016 dhe se kërkuësja ka parashtruar se është vënë në dijeni për aktet/provat e reja, të paraqitura së bashkë me kërkesën, me shkresën e datës 07.07.2016 të Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH). Provat e reja janë: i) shkresa 307, datë 02 maj 1944 nga Banka e Napolit “Shqipni”, drejtuar Zotit Faik Merlika, Krujë; ii) shkresa nr. 3445/58, datë 09.09.1946 e Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës “Seksioni i Financave drejtuar Ministrisë së Financave Tiranë; iii) procesverbali i datës 15 nëntor 1947 në seksionin e financave të qytetit të Tiranës; iv) vendimi i datës 30.11.1997; v) shkresa nr. 8993/1, datë 31.12.1947 e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të qytetit Tiranë, drejtuar Ministrisë së Financave; vi) shkresa nr. 272/3, datë 19.05.1948 e Ministrisë së Financave, drejtuar Bankës së Shtetit Shqiptar. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se dokumentet arkivore të paraqitura nga kërkuësja, duke pretenduar se paditësit në gjykim nuk gëzonin cilësinë e ish-pronarit dhe se ato ishin prova të reja, por në fakt kërkuësja i ka pasur të gjitha mundësitë për t’i gjetur, mjaftonte të tregonte dilijencën e duhur gjatë gjykimit, mjaftonte t’u drejtohej me kërkesë institucioneve përkatëse, sikurse e ka bërë, pasi kishte përfunduar gjykimi. Sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dokumentacioni i paraqitur nga pala kërkuëse, pavarësisht se kur është nxjerrë nga AQSH-ja, ka ekzistuar gjatë gjykimit dhe se pala e paditur nuk ka pasur asnjë pengesë objektive për të paraqitur këto dokumente. Për më tepër, mbrojtja e palës së paditur duhet të kishte qenë e orientuar në hetimin dhe marrjen e këtyre dokumenteve, kur çështja e shtruar për diskutim dhe debati gjyqësor kanë qenë përqendruar pikërisht te fakti nëse paditësit e gëzojnë cilësinë e ish-pronarit. Sipas Kolegjit Civil, kërkuësja nuk kanë qenë përpara situatës, kur me gjithë kërkimet e kryera, objektivisht e ka pasur të pamundur t’i gjejë këto prova dhe njëkohësisht nuk rezulton që kjo pamundësi të ketë ardhur për shkak të veprimeve të kryera me keqbesim të palës kundërshtare. Ndërkohë, pretendimi se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë realizuar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm,

nuk përbën në vetvete shkak për rishikim (*shih paragrafët 37-38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për të gjitha këto arsye, në përfundim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës, për rrjedhojë moscenimin e vendimeve objekt rishikimi.

17. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë, brenda funksionit të saj kushtetues, ka interpretuar shkronjën “a” të nenit 494 të KPC-së, e cila parashikon se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e vendimit gjyqësor që ka marrë formë të prerë kur zbulohen rrethana të reja ose prova të reja me shkresë, të cilat kanë rëndësi për çështjen dhe që nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimi të saj. Duke iu referuar përmbajtjes së dispozitës procedurale, nuk rezulton që interpretimi nga Gjykata e Lartë të jetë me gabime ligjore ose i paarsyeshëm, duke i dhënë përgjigje çdo kërkitimi dhe prove të paraqitur nga kërkuuesja. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit nga Gjykata e Lartë është haptazi i pabazuar.

18. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.